

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Komuna e Podujevës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 615-25-1020-1-1-1

Sa i përket tenderit për : **Furnizimi dhe montimi i serrave (Subvencione për perimkulturë)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SHKELCEN SYLAJ B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Skenderaj

(Adresa)

Skenderaj, Kosovë

41000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 44 708 207

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shkelgensyla@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.05.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vulë)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Publikimet nga AK-Komuna e Podujevës:

- Njoftimi për kontratë: 21.02.2025
- Dosja e tenderit : 25.03.2025
- Afati i fundit për dorëzim ka qene me date: 01.04.2025
- Hapja e tenderit: 01.04.2025 në ora 13:00:00
- Kriteri per dhenje të Kontrates Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
- Vlera e parashikuar 328,571.00 €
- B58 Vendimi i Autoritetit kontraktues : 18.04.2025
- Kërkesa për rishqyrtim pranë AK:21.04.2025
- Pezullimi i aktivitetit të prokurimit :22.04.2025
- Vendimi i AK mbi Kërkesën për Rishqyrtim:23.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kemi marre pjese ne procesin e Hapjes së tenderëve kemi pranuar Procesverbalin e hapjes në menyre elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Komuna e Podujeves ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe letrat standrde.

Me datë 18.04.2025 ku jemi njoftuar se jemi eleminuar nga pjesemarrje e metutjeshme në aktivitetit e prokurimit, arsyeja e eleminimit mos plotësimi i kriterëve rreth pasijeve.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Ne përputhje me LPP si pale në interes ne perputhje nenit 4,2.1 kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht me datë 21.04.2025.Me datë 23.04.2025 AK ka nxjerr Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.Pas kesa kemi kerkuar qasje ne dokumente ne oferten e fituesit dhe me date 30.05.2025 na eshte lejuar qasja me 02.05.2025,vetem ne menyre fizike edhe pse kerkesa jone ishte qe dokumentet te dorezohen permes emailit zyrtar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në bazë të Ligji Nr. 04/L-04PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni dhe Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik janë shkelur:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28.4- Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 29 .1Variantet e specifikimeve teknike

Neni – Përgjegjshmëria e ofertës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 59.4 – Dhënia e kontratës – Tenderi i përgjegjshem çmimi me i ulët

Neni 26.16 parafrasi (ii) i Rregullores Nr. 002/2024

Neni 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Operatorit ekonomik "Shkelqen Sylja "B.I në pajtim me nenin 109 të LPP në afatin e përcaktuar kohor për procedurën e prokurimit me titull **Furnizimi dhe montimi i serrave (Subvencione për perimkulturë) me numer të prokurimit 615-25-1020-1-1-1** të inicuar nga Autorteti kontraktues , Komuna e Podujeves, paraqesim Ankese mbi faktet dhe argumentet tona lidhur me Vendimin e Autoritetit kontraktues, të cilin e konsiderojmë, të padrejtë dhe në kundershtim me dispozitat ligjore të Ligji Nr. 04/L-04PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni dhe Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kjo Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet ka për qëllim të sqarojë dhe të mbështesë pretendimet tona përmes fakteve juridike me qëllim të njoftimit të shkeljeve nga ana e Autoritetit kontraktues në lidhje me eliminimin e Kompanisë sonë në menyrë të padrejtë. Në vijim, po paraqesim shkeljeve nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Pretendimi 1

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i operatorëve ekonomikë

AK ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomikë duke favorizuar ofertuesin me çmim më të lartë, pa dhënë një analizë teknike objektive për ofertën tonë.

Fillimisht jemi njoftuar përmes letrës standarde se jemi eliminuar me arsyetimin se jeni të papërgjegjshëm për shkak se nuk keni ofruar paisjet sipas kërkesës së AK në FTD. Pas kësaj në cilësinë e palës së në interes, kemi parashtruar **kërkesë për rishqyrtim** në këtë aktivitet të prokurimit. Kësaj kërkesë ia kemi bashkangjitur dhe argumentuar deshmë, prova, specifikime teknike për të gjitha pasijet perkatëse në këtë mënyrë duke japur sqarimin e plotë tek AK se pasijet e ofruara përmes ofertes sonë i përmushin kërkesat funksionale dhe teknike sipas kërkesës në dosje dhe në Njoftim për kontratë. Vlen të përmendet, edhe pse specifikimet teknike për pasijet nuk ishin kërkesë e AK, nuk ishin të përfshira në kërkesa të detyrueshme teknike në Aneksin 1 të dosjes së tenderitë e as të kriteret. Në përgjigjeje të këtyre pretendimeve, Komuna e Podujevës, refuzon Kërkesën për rishqyrtim duke na diskriminuar dhe na eliminuar pa të drejtë në anën tjetër duke favorizuar me shprehim me kontratë Grupin e Operatoreve ekonomik : **PMC SH.P.K; KASTRIOTI SM SH.P.K.** Prishtinë me çmim më të lartë prej **324,862.90 €**. I cili nuk e plotëson kriterin e dhënë- **Tenderi i përgjegjshëm çmimi me i ulët.**

Shih arsyetimin e përgjigjejeve ndaj pretendimeve tona ankimore nga ana e AK-Podujevë :

-KOMISIONI VLERESUES KA PERSHKRUAR ARSYETIMIN E PA PERGJEGJESHMERIS SE OFERTËS SUAJ, LLOJIN E PAJISJES CNC, TË PREZANTUAR E CILA NUK E PLOTESON KERKESEN KUALIFIKUESE, PERKATESISHT PAJISJA JUAJ NUK TREGON PËR LLOJIN DHE FORMEN E LAKIMIT TË GYPAVE, DIAMETRIN E TYRE, REZEN E LAKIMIT. NE DUD- IN E PREZANTUAR NE OFERTË PAJISJA CNC NUK I DISPONON KETO KARAKTERISTIKA. NE DT, AK, KA KERKUAR "PRESE HIDRAULIKE PËR PRODHIMIN E LIDHESVE (NYJEVE) TË ELEMNETEVE TË SERAVE, ME KAPACITET PRESIMI APO SHTYPSE MBI 800 KN. PAJISJA E JUAJ NUK KORESPONDON ME KERKESEN E AK-SE DHE NUK DESHMOHET SE E NJEJTA ËSHTË HIDRAULIKE DHE NUK DESHMON PËR KAPACITETIN E SHTYPJES.

Pretendimi 2 Neni 28 Specifikimet teknike Neni 28.4-

Neni 28.4 – Vlerësimi i ofertave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në FTD

AK ka përdorur kriterë të pa përfshira në FTD, me arsyetim se në dokumentin doganor, DUD nuk është e pershkruar diametri dhe rrezja e lakimit, duke llogaritur se dokumenti doganor DUD, është dokument që përmbanë specifikat teknike të pajisjeve gjë që është vlerësuar gabim nga Komisioni i vlerësimit të tenderëve.

Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në rast të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente". Sipas ligjit për prokurimi publik:

Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushtë të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që,

çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”

Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale.

Kompania e jonë me keqardhje vërejtme se Autoriteti kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishyrtim, pa dhënë një arsytim të qartë dhe profesional mbi bazën e provave të dorëzuara me ofertë pasi që me publikimin e Njoftimit B58 na ka eliminuar për mos potesim të tri pasijeve pas kërkeses për rishyrtim dy pasije.

Vlerësojmë se vendimi për eliminimin është marrë nga një komision i cili, në mungesë të njohurive të duhura teknike dhe njohurive për pasijet në fjalë ka konkluduar në mënyrë të gabuar se ato nuk i plotësojnë kërkesat.

Sipas ligjit për prokurim publik Autoriteti kontraktues është i obliguar të pranoj produktë ose paisje ekuivalente, për sa kohe që ato përmbushin kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Në rastin konkret, pasijet e ofruara nga OE “Shkelqen Sylja “B.I” plotësojnë kërkesat minimale disa prej tyre e kalojnë minimumin e kërkuar në FTD, duke përmbushur plotësisht funksionet e kërkuar nga Autoriteti kontraktues.

Mospranimi i tyre, vetëm pse nuk përputhen fjalë për fjalë me përshkrimin në FTD bie ndesh me LPP-në dhe legjislacionin në fuqi pëkatësisht me nenin dhe 28 , 29 të LPP-së

Pretendimi 3

AK-Komuna e Podujeves ka shkelur -Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 në dosje të tenderit me konkretisht rreth pasijeve shih kërkesën/ dëshmitë në dosje të tenderit:

Pajisjet minimale që duhet të ketë OE Kamion për transport, pesha e ngarkesës min 3.5 t. Makinë CNC për lakimin e profileve rrethore metalike për gypat me diametër min 60mm dhe në rreze të lakimit Rmin 115mm. Makinë 9(Presë hidraulike për prodhimin e lidhëseve(nyjeve) të elementeve të serrave, me kapacitet presimi(shtypës) min 800 KN. Makina pneumatike (Cekan pneumatic) për ankerimin (nguljen) e ankerave të serrave min 60mm. Makinë për prerjen e gypave.	Për pajisjet OE Duhet të prezentoj njërin nga këto dokumentë Për automjetet që nuk regjistrohen Dekleratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjetet që paraqiten me fature të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dud-in doganor, Për automjetet që regjistrohen ; Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE-JA nuk posedon pajisjet mbi pronësin atëher OE-ja duhet të ofroj marrveshjen për marrjen me qera të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me lartë, Marrveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohezgjatjes të këtij projekti nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët ,
---	---

Sqarim rreth kërkesave dhe dëshmive të ofruara nga “Shkelqen Sylja “B.I ku ishte kërkesë që pajisjet minimale që duhet të ketë OE sipas kërkesës së AK-së në mënyrë tekstuale si vijon :

- Kamion për transport, pesha e ngarkesës min 3.5t.
- Makinë CNC për lakimin e profileve rrethore metalike për gypat me diametër min 60 mm

dhe me rreze të lakimit Rmin 115mm.

- Makine Prese Hidraulike për prodhimin e lidheseve (nyjeve) të elementeve të serrave me kapacitet presimi (shtypes) min 800 KN.
- Makine pneumatike (Cekan pneumatic) për ankerimin (nguljen) e ankerave të serave min 60mm,
- Makine për prerjen e gypave.

Nga ana jonë janë dorëzuar:

- Libreza e regjistrimit me validitet.
- Marrveshja për marrje ne shfrytezim të pajisjes : MACHINE LINE SB-89 CNC -SR-H, se bashku me DUD dhe faturen blerese.
- Për Makinen Prese Pneumatike, në pronesi të OE, janë dorëzuar **DUD 25194** dhe **Fatura**, ku ne fature qart pershkruhet - J21 Cutting Machine APA60T **PNEUMATIC PUNCHING MACHINE LINE AND HYDRAULIC PRESS MACHINE FOR 100 TON PRESSING.**
- Marrveshje per marrje ne shfrytezim të pajisjeve: Kompresor Ajri me Cekan Pneumatik Tipi:MAP21, bashkagjitur keti dokumenti , DUD-in dhe Faturen.
- DUD-in dhe Faturen, per Makinen Sharre per prerjen e gypave.

Të gjitha dokumentet e kërkuara janë dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe dëshmitë ne FTD-së. Kërkesa për broshura apo specifikime të hollësishme teknike nuk ekziston në FTD, andaj nuk mund të përdoret si bazë për eliminim se ne DUD, ne emertim të pajisjes nuk shkrun forma e gypave dhe rrezja e lakimit. Është totalishtë pa kuptim ky pretendim.

Për më tepër, specifikat teknike të pajisjeve tona janë si më poshtë:

- **CNC SB-89CNC-SR-H.2:** Ø maksimal deri 89 mm, rreze minimale e lakimit 115 mm – përputhje e plotë me FTD ku kereksa ishtë prej ($\text{Ø} \geq 60 \text{ mm}$, $R_{\min} = 115 \text{ mm}$);
- **Presë hidraulike 1000 KN:** Kapaciteti tejkalon kërkesën e FTD-së prej $\geq 800 \text{ KN}$;
- **Sharre elektrike:** Prerje metalesh deri $\text{Ø}90 \text{ mm}$ – përputhje me qëllimin e projektit;
- **Çekan pneumatic MAP21:** Certifikuar për ankerim me $\text{Ø} \geq 60 \text{ mm}$.

Këto të dhëna mund të verifikohen përmes marrëveshjeve dhe përshkrimeve të dokumentuara në ofertën tonë. Vendimi i AK për eliminimin tonë nuk ka marrë për bazë këto specifika, por është mbështetur në dokumentë jo-teknike si DUD-i dhe pa kërkuar asnjë sqarim paraprak – shkelje e qartë e nenit 29.1 të LPP-së.

1. Pajisjet e ofruara përmbushin tërësisht FTD

- Për **CNC**, është ofruar Makineria SB-89CNC-SR-H.2, e cila mbulon Ø deri **89 mm** me $R_{\min} = 115 \text{ mm}$ – përputhje e plotë me FTD që kërkon $\text{Ø} \geq 60 \text{ mm}$ dhe $R_{\min} = 115 \text{ mm}$.
- Presa e ofruar është hidraulike me kapacitet **1000 KN (100 ton)**, ndërkohë që FTD kërkon $\geq 800 \text{ KN}$ – tejkalim i specifikës teknike. Kjo mund të verifikohet si ne DUD e po ashtut edhe ne fature.
- Sharre elektrike për prerje metalesh deri $\text{Ø}90 \text{ mm}$ – pajisje e përshtatshme për qëllimin

e projektit.

- Kompresor ajri me çekiç pneumatic MAP21 – i certifikuar për $\varnothing \geq 60$ mm. **Kompresor ajri me cekan, nenkupton se është pajisje me e avansuar sesa vetem cekan pneumatik.** Pra vetë termi dhe vetë pajisja Kompresor ajri me cekan pneumatik nenkupton se perdoret per ankerim (nguljen e ankerave të serave) dhe jo vetem, por per cdo lloje tjeter të kesaj natyre të punes.

2. Autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar broshura ose specifikime teknike

Në FTD nuk ka asnjë kërkesë të qartë për broshura teknike apo fletë teknike. Ne kemi dorëzuar marrëveshje përdorimi dhe përshkrime teknike për secilën pajisje. Mosparaqitja e specifikimeve në DUD nuk mund të interpretohet si mospërputhje, pasi DUD është dokument fiskal, jo teknik.

4. Vlerësim joprofesional dhe i njëanshëm

Në asnjë vend të vendimit të eliminimit nuk jepen prova konkrete për përpjethshmëri. Nuk ka analizë teknike të asnjë pajisjeje. Vendimi është i përgjithshëm dhe pa bazë faktike.

Pretendimi 4 - Kërkesa për sqarime

Nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me dokumentacionin tonë, ka mundur të kërkojë sqarime. AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim për dokumentet tona. Sipas Legjislacionit ne fuqi autoriteti ka të drejtë dhe detyrë të kërkojë sqarime para eliminimit. Kjo e drejtë nuk është shfrytëzuar, duke na mohuar mundësinë për të sqaruar çdo paqartësi të pretenduar dhe duke shpërblyer Grupin e Operatoreve ekonomik PMC SH.P.K; KASTRIOTI SM SH.P.K. Prishtinë me çmim më të lartë prej 324,862.90 €. I cili nuk është i përgjegjeshëm dhe nuk e plotëson kriterin e dhënë- Tenderi i përgjegjeshëm çmimi me i ulët.

Autoritetit kontraktues nuk ka kërkuar sqarime ne lidhje me paisjet duke shkelur nenin 38.4 të Rregullores per prokurim publik në fuqi si vijon:

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtese në kushtë të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët Ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumentë është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti Kontraktues mund të ftojë Operatorët Ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

Në këtë kontekst, lind nevoja për të vlerësuar arsyetimin dhe e qasjes së ndjekur nga autoriteti kontraktues në këtë proces për të na eliminuar pa të drejtë pasi që kemi qene Operatori ekonomik me çmimin përgjegjeshëm me të lirë.

Pretendimi 5

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin detyrues lidhur me këtë çështje.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Komisioni i vlerësimit shkon tujte duke duke shkelur neni 59 të LPP, shih kriteret nga ana e AK, rreth permbushjes së kontrave të ngajshme në dosje të tenderit;

Pretendimi 6

Mosperbushja e kriterëve për Pasiqe nga OE fitues

Pajisjet minimale që duhet të ketë OE Kamion për transport, pesha e ngarkesës min 3.5 t. Makinë CNC për lakimin e profileve rrethore metalike për gypat me diametër min 60mm dhe në rreze të lakimit Rmin 115mm. Makinë 9(Presë hidraulike për prodhimin e lidhësve(nyjeve) të elementeve të serrave, me kapacitet presimi(shtypës) min 800 KN. Makina pneumatike (Cekan pneumatic) për ankerimin (nguljen) e ankerave të serrave min 60mm. Makinë për prerjen e gypave.

Për pajisjet OE Duhet të prezentoj njërin nga këto dokumente Për automjetet që nuk regjistrohen Dekleratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjete që paraqiten me fature të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dud-in doganor, Për automjetet që regjistrohen ; Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE-JA nuk posedon pajisjet mbi pronesin atëherë OE-ja duhet të ofroj marrveshjen për marrjen me qera të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesë me lartë, Marrveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohezgjatës të këtij projekti nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët ,

ANEKS TEKNIK – KRAHASIM I PAJISJEVE TË OFRUARA NGA GRUPI FITUES ME KËRKESAT E FTD-SË

Ky dokument përmban një analizë teknike dhe krahasuese ndërmjet pajisjeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit (FTD) dhe atyre të dorëzuara nga grupi i operatorëve ekonomikë "KASTRIOTI SM SH.P.K & PMC SH.P.K", të shpallur fitues në prokurimin me nr. 615-25-1020-1-1-1. Analiza bazohet në dokumentet e dorëzuara nga grupi, përfshirë përshkrimin e pajisjeve, DUD, dhe argumentet teknike të prodhuesit.

1. KËRKESA NGA AK:

- Kërkohet: Makinë CNC për lakimin e profileve rrethore metalike për gypat me diametër min.

60 mm dhe në rreze të lakimit Rmin 115 mm.

- Grupi fitues ka dorëzuar: HYDRAULIC PROFILE BENDING MACHINE MODEL PRF-89.
- Dokumentacioni teknik i prodhuesit ALMACO nuk e klasifikon si CNC.
- Në DUD, me referencë doganore R 80298, pajisja përshkruhet: "MAKINË PËR PROCESIN E PRODHIMIT TË KONSTRUKSIONEVE METALIKE – MAKINË HIDRAULIKE PËR LAKIMIN E GYPAVE: 7.5KW, MODEL: PRF-89, MARKA: ALMACO, VP:2024".

Konkluzion: Nuk përputhet me FTD. Kriteri thelbësor është që të jetë makinë CNC për lakimin e profileve rrethore metalike për gypat me diametër min. 60 mm dhe rreze lakimi Rmin 115 mm – kjo pajisje nuk është CNC.

Në katalogun e prezantuar për këtë pajisje gjithashtu vërtetohet se bëhet fjalë për një makinë hidraulike, jo CNC.

2. KËRKESA NGA AK:

- Kërkohet: Makina pneumatike (çekan pneumatik) për ankerimin e ankerave të serave me diametër min. 60 mm.
- Grupi fitues ka dorëzuar: MAKINË DORE PËR VENDOSJEN E SHTYLLAVE MINI GASOLINE / PILE DRIVER (JIANGSU).
- Në DUD, me referencë doganore R 27066, pajisja përshkruhet si: "MAKINË DORE PËR VENDOSJEN E SHTYLLAVE (MINI GASOLINE / PILE DRIVER) JIANGSU", e cila është makinë me benzinë.

Sipas USER MANUAL-it të prezantuar nga grupi fitues: "FOUR STROKE PILE DRIVER / USER MANUAL", pajisja ka: motor me benzinë, një cilindër, ftohje me ajër dhe katër takte.

Konkluzion: Kjo nuk është pajisje pneumatike, siç kërkohet nga AK tek FTD-ja – pra ka një devijim serioz nga specifikimet.

3. MOSPËRPUTHJE ME KËRKESAT E AK:

- Dokumentet DUD dhe faturat nuk përmbajnë termin CNC apo pneumatike.
- Vetë dokumentet doganore konfirmojnë mospërputhjen me kërkesat teknike sipas pikave 9.1 dhe 9.2 të FTD-së.

4. TRAJTIM I PABARABARTË DHE SHKELJE E LIGJIT PËR PROKURIM PUBLIK:

- Ne si operator ekonomik kemi ofruar pajisje të përputhshme teknikisht: CNC SB-89, presë 1000 KN, MAP21 Çekan pneumatic.
- Grupi fitues është favorizuar pavarësisht mospërputhjes teknike.
- Është shkelur neni 7, 28.4 dhe 30 i Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos u siguruar trajtim i barabartë dhe vlerësim objektiv.

Pretendimi 7 –Mospermbushja e kriterëve ne dosje rreth kontratve

Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere jo me pak se **480,000.00 €** ne tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit njoftimit te kontrates. Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë **së paku 51% të**

Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet të saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkangjiten **referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.**

Grupi i OE:PMC SH.P.K;KASTRIOTI SM SH.P.K.Prishtinë me çmim më të lartë prej **324,862.90 €** është i papërgjegjshëm.

Sipas dosjes së tenderit, vlera **480,000.00 €** Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar. Kjo nënkupton që **kapaciteti profesional dhe përvoja relevante** e liderit duhet të jenë të mjaftueshme për ta përmbushur vetë këtë përqindje.

Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të ofertës së OE-së së shpërblyer, konstatohet se:

1. Shumica e referencave të paraqitura nga lideri janë kontrata me IADK, e cila nuk është autoritet kontraktues publik sipas Ligjit për Prokurimin Publik, nuk i nënshtrohet Ligjit për Prokurim Publik dhe konsiderohet blerës privat dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet dhe keto referenca nuk janë ma Autoritet publik.

Referencat me vlerë 27,000.00 €,18,744.00€,11,928.00€,11,500€,19,461.00,54000.00 janë nga IADK dhe sipas nenit 26.16 pika (ii) si vijon:

26.16 (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

Bazuar në këtë Lideri I grupit KASTRIOTI SM SH.P.K ka ofruar Urdheblerje e cila ligjerisht i jep urdher Operatorit ekonomik te realizoj kontraten si pas afatit kohor në rastin konkret, ne kuader të ketyre urdherblerjeve shkruan data e fundit per furnizim dhe kjo nuk eshte deshmi e pagesave nga banka, por nje urdher per të kryer furnizimin Operatori eknomik pa te cilen nuk nuk mund te filloj furnizimin apo punen.

2.Edhe referencat 12,351.00€ dhe 13,450€ te leshuara nga "LAB" nuk përmbajnë asnjë dëshmi pagese ose dokument tjetër.

3.Kontata me vlerë prej 66,400.00€ ka nje dokument i pranimit teknik i pa padukshem, fotokopje jo nga origjinali dhe i palexueshem.

4.Një prej referencave më vlerë 202,500.00 €, e kontrates me vlerë 175,500.00 € me nr.656-24-1805-1-1-1 e leshuar e date 04.03.2025 me pak se nje muaj para dorëzimit te ofertes edhe pse document I leshuar mjaft vone, permban vulë të pa dukshme qe e ben te dyshimte(te paqartë) kete reference dhe për këtë Autoriteti kontraktues do te duhej te kerkonte sqarim lidhur me padukshmerine e dokumentit per të pranuar si të sakte.

Kompania e jone nga të gjitha dëshmitë e cekura me lartë konstojme se , **lideri i grupit KASTRIOTI SM SH.P.K nuk e ka permushur kriterin - udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar**, dhe kjo përben shkelje të qartë të kërkesave të dosjes se tenderi nga ana e Komisoinit të Vleresimit, ku nga ana e tyre jane pranuar dokumente te paqarta te pa sakta dhe pa dëshmi transaksioneve apo pagesave.Ne këtë rast AK-Komuna e Podujeves do te duhej te nxjerr vendim në refuzimin e ofertës si të papërgjegjshme dhe jo të shperblej me Kontratë Grupin e OE: PMC SH.P.K;KASTRIOTI SM SH.P.K.Prishtinë me çmim më të lartë prej **324,862.90 €**. I cili nuk e plotëson kriterin e dhënë- **Tenderi i përgjegjshem çmimi me i ulët**.

Sipas nenit 25.16 pika (ii) Në përputhje me nenin 69 të LPP-së, AK mund të kërkoj nga OE një

listë të furnizimeve/shërbimeve/punëve të realizuara në 3 vitet e fundit. Kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi:

(ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;

AK ka shpërblyer një ofertë më të shtrenjtë duke eliminuar ofertën tonë më të lirë dhe teknikisht përputhëse, në kundërshtim të plotë me këtë nen.

Pretendimi 8

Sigurimi i Ofertes

Pas qasjes ne dokumentacion kemi verejtur se OE fitues nuk e ka dorezuar Sigurimin e ofertes ne emer te konzeciumit e as ne emer te Liderit pore ne mer te PMC SH.P.K.

Pretendimi 9.

Menaxheri i kontrates

Bazuar ne kerkesen ne dosje Vendimi i caktimit te menanxerit dhe referenca jane dorezuar nga vet perosoni i cili nuk eshte ne listen e puntorve dhe nuk e permbush kereksen e AK-se. Referenca, Vendimi , Kontrata e punes jane te nenshkrua nga vet personi qe len dyshim per saktesine e dokumteve.

Pretendimi 9

Neni 59.4 – Dhënia e kontratës Ofertes se papergjegjeshme

Argumentimi i Autoritetit kontraktues –Komuna e Podujevës 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ky nen përcakton qartë se një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk e ka marrë për bazë neni e lartëcekur dhe kjo bie ndesh me këtë dispozitë ligjore, pasi nuk garanton që oferta e zgjedhur përmbush kriteret e kërkuara. Në veçanti:

- Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurohet që çdo tender i përgjegjshëm përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, edhe çmimin me të ulë si krter i vendosur nga na e vet Autoritetit kontraktues
- Arsyetimi se ne nuk i plotesojme kerkesa mbi pasijet nuk qendron , pasi ligji nuk përjashton kërkesat themelore të vlerësimit edhe në rastet kur
- shperblimi i OE me çmim me të lartë shkel parimin e barazisë në trajtim dhe ndikon në transparencën e procesit të prokurimit, duke krijuar mundësi për keqpërdorime ose trajtim preferencial.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59.4 të LPP dhe OSHP duhet të marrë masat e nevojshme për të adresuar këtë shkelje dhe për të garantuar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë po ashtu kërkojme nga Organi shqyrtues i Prokurimit publik që të caktoj në ekspert nga lëmija e makinerisë për të vertetuar se ne si Operator ekonomik i përmbushim të gjitha kërkesat nga ana e jonë të dorëzuara me Ofertë.

Përgjegjshmëria e ofertës

AK nuk ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe objektive ofertën tonë dhe nuk ka marrë parasysh

Pretendimi 10

Shkelje e nenit 61.3 Rregullores Nr. 002/2024

Neni 61.3 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Në përputhje me nenin 61.3 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, është i detyruar të publikojë Kërkesën për Rishqyrtim në Platformën e Prokurimit Elektronik, tek dosja e tenderit në seksionin “shto dokument shtesë”.

61.3 Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të publikojë Kërkesën për rishqyrtim në Platformë tek dosja e tenderit në “shto dokument shtesë” dhe do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në rastë specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Në këtë rast, AK-Komuna e Podujeves nuk ka përmbyllur këtë detyrim ligjor, duke mos publikuar Kërkesën për Rishqyrtim. Kjo përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe integritetit, pasi mungesa e publikimit pengon palët e interesuara të kenë qasje në informacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.

Si rrjedhojë, kërkohet që OSHP të konstatojë këtë shkelje dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që Autoriteti Kontraktues të respektojë detyrimet ligjore dhe të garantojë një proces të drejtë dhe transparent të prokurimit.

Ankesat dhe kompetencat e OSHP-së, OSHP ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar ankesën tonë dhe të ndërhyjë për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara nga AK.

Bashkangjitur gjeni dëshmitë dokumentare rreth kësaj ankese edhe tek dokument shtojca ne pteforem elektoronike.

Duke u bazuar në shkeljet e sipërpërmendura dhe dispozitat ligjore të LPP, Rregullores Nr. 002/2024, kërkojmë nga OSHP:

Anulimin e Vendimit të Autoritetit kontratues B58 i datës 18.04.2025 në këtë aktivitet të prokurimit, kthimin e lëndës në rivlerësim dhe të shpërblej Kompanine tone me kontratë OE “Shkelqen Syla”B.I. me çmim të përgjegjeshem me te ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtësisht ofertën tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

1. Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
2. Kostoja e përgaditjes së kërkesës për rishqyrtim , Ankeses në OSHP;
3. Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontratë të mundshme;
4. Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.
5. Obligimin e AK për rishikim të procesit të prokurimit, duke respektuar dispozitat ligjore dhe standardet e transparencës dhe barazisë

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraparak të zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*